



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202200371/12

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandohet hartimi dhe miratimi i rregullave lidhur me rastet kur punonjësit e policisë së shtetit do të kryejnë detyra në publik pa uniformë*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Të nderuar,

Në muajin Mars 2022 në disa qytete të vendit janë zhvilluar protesta për të shprehur pakënaqësinë për rritjen e çmimeve të disa produkteve, e në mënyrë të veçantë të karburantit, mallrave të shportës, etj.

Gjatë transmetimit të tyre, në media janë shfaqur pamje të disa personave të veshur civilë, të cilët kanë kufizuar fizikisht protestues dhe më pas i kanë dorëzuar këta shtetas tek punonjës të policisë të veshur me uniformë për t'i shoqëruar në mjediset e policisë.

Lidhur me këto veprime është ngritur shqetësim në media nga qytetarë të ndryshëm, duke i konsideruar si të paligjshme, pasi punonjësit e policisë të veshur civilë nuk janë identifikuar si të tillë duke sjellë mosbindjen ndaj urdhrave të tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur një hetim administrativ lidhur me këtë shqetësim të bërë publik në media. Gjithashtu, edhe Z. Petrit Vasili, deputet i subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim në kohën e paraqitjes së ankesës dhe aktualisht “Partia e Lirisë”, ka paraqitur një ankesë në institucionin tone, referuar këtyre episodeve të sipërpërmendura.

Nga ana jonë janë administruar pamjet e bëra publike ku punonjës të policisë të veshur civilë kufizojnë protestues dhe i dorëzojnë tek punonjës të policisë të veshur me uniformë.

Një nga këto episode, i referuar se ka ndodhur në Durrës, është ai i disa punonjësve të veshur civilë, të cilët po kufizojnë fizikisht protestues, në krah të rrugës automobilistike. Në një çast, njërit prej punonjësve të veshur civilë i ekspozohet arma që mban në brez, në krahun e djathtë.

Episodi që ka tërhequr më shumë vëmendjen është ai i disa punonjësve të veshur civilë, me kokë të mbuluar me kapuçin e xhupit, veprimet e të cilëve po mbikëqyren nga Drejtori i Policisë Vendore Tiranë Z. Lorenc Paganika. Në çastin që këta punonjës po hipin me forcë në automjetin e policisë një shtetas, Z. Paganika u drejtohet me fjalët “*avash se ka gazetarë*”. Këto fjalë janë interpretuar në media si përpjekje e drejtuesve të Policisë së Shtetit për të fshehur veprimet e paligjshme të vartësve të tyre.

Pamjet e episodit të tretë që kemi të dokumentuar kanë të bëjnë me një shtetas që është kufizuar fizikisht nga punonjës të veshur civilë, i cili vetë identifikohet me emrin E. Z. dhe që pretendon se është goditur me grusht në fytyrë nga punonjës të policisë.

Të gjitha këto situata iu referuan Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke kërkuar informacion lidhur me njoftimet e bëra nga organizatorët e protestave, veprimet e punonjësve të policisë të veshur civilë dhe rregullat që zbatohen nga ana e tyre në këto raste.

Referuar përgjigjes dhe dokumentacionit që na ka dërguar Drejtoria Vendore e Policisë Durrës me shkresën Nr.3582/1 Prot., datë 26.04.2022 rezulton se: në këtë strukturë janë depozituar dy kërkesa për organizim proteste kundër rritjes së çmimit të karburantit dhe ndërgjegjësimit për probleme të tjera sociale. Një kërkesë është nënshkruar në datën 01.03.2022, ku bëhet njoftimi se protesta do të organizohet nga data 09.03.2022 e në vazhdim, në orën 16:30, tek Shehi “Liria”, pranë Bashkisë Durrës. Ndërsa kërkesa tjetër është nënshkruar në datën 10.03.2022 ku njoftohet se protesta do të zhvillohet në datën 11.03.2022, në sheshin para Pallatit të Kulturës, Durrës. Për këto kërkesa janë kthyer përgjigje për plotësim, pasi nuk përmbanin disa nga elementët e parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të Ligjit Nr.8773, datë 23.04.2001 “Për Tubimet”.

Qëndrimi i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës lidhur me veprimet e punonjësve të policisë në këto protesta është si më poshtë vijon:

“Ndërhyrja për kapjen e shoqërimin e personave në tubim/protesta janë kryer nga shërbimet e patrullave të Përgjithshme dhe Shqiponjave, vetëm në raste të caktuara. Punonjës Policie të strukturave të hetimit të krimeve kanë bërë bllokimin e tyre në vend duke u prezantuar si punonjës policie dhe më pas shoqërimi është bërë nga shërbimet me uniformë policie.

Veprimet për bllokimin e protestuesve nga ana e punonjësve të policisë të strukturave të hetimit të krimeve kanë qenë të nevojshme në rrethanat kur protestuesit nuk iu janë bindur thirrjeve për mos bllokimin e rrugëve dhe kanë tentuar me forcë çarjen e kordonëve të policisë të vendosur për të mos bllokuar autostradën Durrës-Tiranë.

Punonjës të policisë janë të pajisur në çdo rast me mjet identifikimi dhe në të gjitha rastet e ndërhyrjeve janë identifikuar si punonjës policie duke iu bërë thirrje protesutesve për ndalimin e veprimeve të dhunshme ndaj policisë.

Nuk janë paraqitur ankesa lidhur me veprimet e punonjësve të policisë gjatë protestave të muajit Mars 2022 nga ana e personave të shoqëruar.

Arsyeja e shoqërimit të këtyre shtetasve ka qenë “Person ndaj të cilit ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale”, mbështetur në nenin 109/1/c të Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, pasi dyshohet se kanë kryer veprat penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manisfestime të paligjshme”, “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit” dhe “Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë”.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore janë referuar në prokurori gjithsej pesë raste, në lidhje me protestat e muajit Mars të vitit 2022”.

Referuar përgjigjes dhe dokumentacionit që na ka dërguar Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me shkresën Nr.4334/1 Prot., datë 20.04.2022 rezulton se: në këtë strukturë të Policisë së Shtetit janë depozituar katër kërkesa për organizim proteste kundër rritjes së çmimit të karburantit, gazit dhe ushqimeve. Kërkesat janë si më poshtë vijon:

- Kërkesë e datës 17.03.2022 për tubim në datën 19.03.2022, nga ora 11:00 deri në orën 17:00. Vend grumbullimi pranë monumentit të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe marshim përgjatë Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” drejt Kryeministrisë ku dhe do të qëndrohet.
- Kërkesë e datës 19.03.2022 për tubim 24 orë. Vend grumbullimi në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe Kryeministria ku dhe do të qëndrohet.
- Kërkesë e datës 26.03.2022 për tubim në datën 29.03.2022, nga ora 17:00 deri në orën 19:00. Vend grumbullimi në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe Kryeministria ku dhe do të qëndrohet.
- Kërkesë e datës 26.03.2022 për tubim në datën 02.04.2022, nga ora 11:00 deri në orën 14:00. Vend grumbullimi në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe Kryeministria ku dhe do të qëndrohet.

Qëndrimi i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë lidhur me veprimet e punonjësve të policisë në këto protesta është si më poshtë vijon:

“Me qëllim marrjen e masave të plota, garantimin e rendit dhe sigurisë publike, lehtësimin e lëvizjes së lirë të përdoruesve të rrugëve (nisur nga fakti që një pjesë e bulevardit do të bllokohej nga përdoruesit), parandalimin e ndonjë ngjarje të mundshme kriminale apo terroriste, veç planifikimit të punonjësve të policisë me uniform, janë planifikuar dhe shërbime nga strukturat e hetimit të krimeve (civilë).

Ndërhyrjet për shoqërimin e protestuesve që bllokuan rrugët dhe qarkullimin e mjeteve (edhe pse iu bë thirrje disa herë për lirimin e rrugëve), janë kryer nga punonjës policie të strukturave të rendit si dhe nga punonjës civilë të strukturave të hetimit të krimeve, të cilët janë prezantuar dhe identifikuar para qytetarit në momentin e ndërhyrjes me dokumentin “Policia”. Çdo shtetas i shoqëruar për bllokim rruge edhe pse në momentin e parë është shoqëruar nga punonjës policie civilë, shoqërimi i tyre për në ambientet e policisë është bërë me mjet policie të loguar dhe punonjës të rendit me uniformë.

Punonjësit e policisë janë pajisur me dokument “policia”. Shoqërimet janë kryer nga të gjitha strukturat e policisë duke zbatuar detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Rregulloren e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM Nr.750, datë 16.09.2015, neni 37, si dhe Procedura Standarte e Punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” miratuar me Urdhër Nr.938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në regjistrat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar nuk kemi të evidentuar ankesa, kërkesa nga persona të shoqëruar/arrestuar, por dhe nga të afërm të tyre për ushtrim dhune gjatë shoqërimit.

Në rastet e shoqërimit të shtetasve të ndryshëm, të cilët me veprimet e tyre bllokuan disa akse rrugore (kryqëzime), siç e kemi përmendur më sipër janë zbatuar detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore, si dhe janë porositur shërbime të

komunikojnë me etikë, të mos pengojnë personat e tjerë të kryejnë detyrat (siç janë edhe gazetarët), porosi e cila është dhënë herë pas here nga drejtuesit e shërbimeve, rasti konkret është porosia e Drejtorit Vendor të Policisë, shfaqur në rrjetet sociale.

Në lidhje me shtetasin E. Z., nga verifikimet e bëra nuk rezulton të jetë shoqëruar nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Për shtetasit e ndaluar/arrestuar për “Pengimin e qarkullimit të mjeteve të transportit” dhe “Prishje e rendit dhe qetësisë publike”, veprimet procedurale të kryera nga policia gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka vlerësuar të ligjshme”.

Ndërsa në përgjigjen e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën Nr.715/3 Prot., datë 18.07.2022, në mënyrë të përmbledhur sqarohet se: gjatë tubimeve, shërbimet policore organizohen në mënyrë të tillë që të mbahet rregulli, të vrojtohen dhe parandalohen veprime që bien në kundërshtim me ligjin si dhe të bashkërendohet puna me organizatorët e tubimit. Në të tilla raste angazhohen edhe punonjës të veshur civilë, të cilët kur kryejnë veprime me shtetasit prezantohen si punonjës policie duke treguar dokumentin e identifikimit me mbishkrimin “Policia”.

Pas analizës së përgjigjeve, dokumentacionit si dhe kuadrit ligjor në kuadër të këtij hetimi administrativ, arrijmë në përfundimet si më poshtë vijon:

Legjislacioni në fuqi nuk vendos ndalime për punonjësit e policisë të veshur civilë për të kufizuar fizikisht persona dhe për të realizuar shoqërimin e tyre në mjediset e strukturave të Policisë së Shtetit, nëse dyshohet se këta shtetas kanë kryer një vepër penale.

Më konkretisht, detyrat e Policisë së Shtetit përcaktohen në nenin 17 të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Ndër këto detyra përmendim:

1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë:

- a) mbron jetën, shëndetin, pronën publike dhe private;
- b) ruan rendin dhe sigurinë publike;
- c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin në fuqi, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre.

Ndërsa rastet e shoqërimit të shtetasve përcaktohen në nenin 109, pika 1 të Ligjit Nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”. Citojmë:

“1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

- a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;*
- b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;*
- c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;*
- ç) për të parandaluar kryerjen e një vepre penale;*
- d) kur është larguar pas kryerjes së një vepre penale;*
- dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;*
- e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;*
- ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;*
- f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit”.*

Punonjësi i Policisë së Shtetit, i veshur civil, gjatë kryerjes së detyrave në publik i nënshtrohet disa rregullave të parashikuara në Rregulloren e Policisë së Shtetit, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 16.09.2015.

Më konkretisht këto rregulla janë të përcaktuara si më poshtë vijon:

Neni 37, pika 5

“Në rast se punonjësit e strukturave qendrore dhe vendore për hetimin e krimeve do të kryejnë detyra në publik pa uniformë policie, ata janë të detyruar të identifikohen si punonjës të Policisë së Shtetit, sipas rregullave të përcaktuara për këtë qëllim”.

Neni 58

“Punonjësi i policisë që mban armë zjarri, përgjigjet për marrjen e masave që kanë të bëjnë me shmangien e:

- a) dëmtimeve të armës, humbjes dhe përdorimit të saj nga persona të tjerë;*
- b) modifikimit të armës dhe të municioneve;*
- c) qitjeve aksidentale;*
- ç) demonstrimeve të panevojshme dhe kërcënuese”.*

Neni 59, pika 2

“2. Në situatat e punës, kur punonjësi i policisë nuk është i veshur me uniformën e policisë, ai detyrohet të tregojë kujdes maksimal për shmangien e ekspozimit të armës individuale”.

Neni 120, pika 3

“Punonjësi i policisë gjatë detyrës/shërbimit zbaton detyrimet dhe normat e sjelljes, si më poshtë:

3. tregon dokumentin e identifikimit policor kur është me veshje civile apo kur pyetet, për të verifikuar autoritetin e tij policor”.

Nga ana jonë, mbi bazën e të gjithë akteve të administruara nuk mund të provohet nëse punonjësit e policisë të veshur civilë janë identifikuar apo jo si të tillë para

shtetasit, të cilin e kanë kufizuar. Ajo që evidentohet nga pamjet e administruara është se këta punonjës gjatë shoqërimit të këtyre shtetasve nuk mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen *Ataykaya v. Turkey* është shprehur se, kur autoritetet kompetente caktojnë me detyrë punonjës të maskuar për të ruajtur rendin dhe sigurinë, apo për të kryer arrestime, këta punonjës duhet të mbajnë një dokument identifikimi të dukshëm, psh. një numër, i cili ruan anonimatit e tyre, por njëkohësisht bën të mundur identifikimin, nëse është e nevojshme të kryhen verifikime lidhur me veprimet/mosveprimet e paligjshme. Në të kundërt, krijohet një gjendje pandëshkueshmërie dhe pamundësia e identifikimit të punonjësve bën që hetimet të mos jenë efektive. Pyetjes sonë drejtuar tre institucioneve të lartpërmendura, nëse janë miratuar rregulla të posaçme në rastet kur punonjësit e strukturave qendrore dhe vendore për hetimin e krimeve do të kryejnë detyra në publik pa uniformë policie, në zbatim të nenit 37, pika 5 të Rregullores së Policisë së Shtetit, nuk i është kthyer një përgjigje.

Gjithashtu, pamjet që kanë fiksuar veprimet e punonjësve të policisë të veshur civilë, gjatë protestës në një pjesë të autostradës Tiranë – Durrës, dëshmojnë se një prej punonjësve nuk ka treguar kujdes që të mos ekspozojë armën e shërbimit, shfaqje kjo e panevojshme, në një situatë që nuk përbënte rrezik për jetën dhe shëndetin e punonjësve apo personave të tretë.

Në vlerësojmë se përcaktimi i rregullave të qarta që duhet të zbatojnë punonjësit e policisë që do të kryejnë detyra në publik pa uniformë është shumë i rëndësishëm. Nga njëra anë kjo lidhet me përmbushjen e detyrës në përputhje me kuadrin ligjor dhe nga ana tjetër për të parandaluar çdo veprim të kryer nga ana e tyre në tejkalim të ligjit dhe respektimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të shtetasve. Gjithashtu, vetëm në këtë mënyrë autoritetet kompetente mund t'u përgjigjen veprimeve të kundërligjshme, duke hetuar me efektivitet dhe ndëshkuar punonjësit në përputhje me rrethanat.

Ne çojmë gjithashtu se duhet të jetë shqetësim edhe i strukturave shtetërore rritja e besimit të qytetarëve tek forcat e policisë dhe për këtë përpjekjet duhet të jenë

thelbësore dhe efektive. Që nga miratimi i Rregullores së Policisë së Shtetit me VKM Nr. 750 datë 16.09.2015, ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, brenda së cilës Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të kishte miratuar rregullat e posaçme në frymën e mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut dhe uljes së pandëshkueshmërisë. Besimi tek Policia e Shtetit rritet vetëm nëse ky organ tregon se ligji vepron edhe për ta.

Në Raportin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) të Këshillit të Evropës, i bërë publik në datën 17.09.2019, është rekomanduar që autoritetet shqiptare duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjësit e policisë. Në veçanti, duhet t'u silltet në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtitimit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat.

Për më tepër, në pjesën e raportit që ka të bëjë me Policinë e Shtetit¹, shkronja “A”, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar. Disa nga rekomandimet që kanë të bëjnë me parandalimin e keqtrajtitimit, përdorimin e forcës dhe hetimin e ankesave ndaj Policisë së Shtetit, janë si më poshtë:

“A. Ndalimi nga Policia

2. Keqtrajtimi

14. Është thelbësore të sigurohet që punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.

¹ Për më shumë shih:

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjës të policisë. Në veçanti, duhet t'u sillet në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtitimit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohet në përputhje me rrethanat.

Oficerët e policisë gjithashtu duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është nevojshme kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme.

15. Përbërës thelbësor i çdo strategjie për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një të dhëne për keqtrajtim, personat e cënuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Hetime të tilla duhet të përputhen ndër të tjera me kriterin e shpejtësisë, tërësisë dhe gjithëpërfshirjes.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive".

REKOMANDOJMË:

- Hartimin dhe miratimin e një procedure standarde në zbatim të nenit 37, pika 5 të Rregullores se Policisë së Shtetit, lidhur me rregullat që duhet të zbatohen në rastet kur punonjësit e Policisë së Shtetit, efektivë të strukturave qendrore dhe vendore për hetimin e krimeve, do të kryejnë detyra në publik

pa uniformë. Në hartimin e këtyre rregullave të kihet në vëmendje praktika e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut për rastet konkrete.

- Marrjen e masave për trajnimin e punonjësve të strukturave qendrore dhe vendore për hetimin e krimeve me qëllim që kur kryejnë detyra në publik pa uniformë si dhe në rastet kur ndërhyjnë për të arrestuar apo shoqëruar persona të dyshuar si autorë të veprave penale të identifikohen/prezantohen me dokumentin zyrtar si punonjës të Policisë së Shtetit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi